Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 76/17, 79/18, 82/17
Datë/Datum. 03.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

AKT PËRCJELLËS

DATË/A:	03.04.2017
REFERENCË:	
PËR/ZA/TO:	**Menaxherin e prokurimit:** Agjencia Qendrore e Prokurimit
CC:	- **Paneli Shqyrtues - OSHPNr.76/17, Nr.79/18 dhe Nr.82/17** - **OE "Laguna" Sh.P.K** ankesë për **Lot 1 dhe Lot 10** - **OE "Uni - Project "** ankesë për **Lot 1 dhe Lot 10** - **OE "NTP Beni & Euroing ShPK"** ankesë për **Lot 1.**
NËPËRMJET/PREKO/THROUGH	
NGA/OD/FROM:	**Muhamet Kurtishaj - Ekspert Shqyrtues/teknik**
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	**"Shërbime te pastrimit" Lot 1 dhe Lot 10, Ri tender me nr. prokurimi AQP 15 010 211**

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP-së ju njoftojmë me raportin e lëndës lidhur me aktivitetin e **"Shërbime te pastrimit" Lot 1 dhe Lot 10, Ri tender** me nr. prokurimi AQP 15 10 211 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia Qendrore e Prokurimit** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik **Kompania Pastrimit "Laguna" Sh.P.K** me nr.**76/17** të datës **15.03.2017**, operatori ekonomik **"Uni - Project "**me nr.**79/17** të datës **17.03.2017** dhe OE **"NTP Beni & Euroing ShPK** me nr.**82/17** të datës **23.03.2017.**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit, përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

	24.03.2017		25.03.2017		03.04.2017
Nënshkrimi i ekspertit	Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të raportit		data e dorëzimit të raportit

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë **15.03.2017** Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit **Nr.76/17** e parashtruar nga operatori ekonomik **Kompania Pastrimit "Laguna" Sh.P.K** me seli ne Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Shërbime te pastrimit" Ri tender Lot 1 dhe Lot 10,** po ashtu me datën **17.03.2017** OSHP ka pranuar ankesën tjetër me nr. Protokolli **79/17** të parashtruar nga kompania e pastrimit **"Uni - Project"** me seli ne Prishtinë lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Shërbime te pastrimit" Ri tender Lot 1 dhe Lot 10** ndërsa me datën **23.03.217** OSHP ka pranuar ankesën e tjer te OE ankues **"NTP Beni & Euroing ShPK"** për **Lot 1** për kativitetin e prokurimit me nr. prokurimi AQP 15 10 211 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Agjencia Qendrore e Prokurimit.**

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-*Operatori Ekonomik Ankues* Kompania Pastrimit "Laguna" Sh.P.K me seli ne Prishtinë

***Pikat e Ankesës:* Lot 1 dhe Lot 10**

Është shkel neni 59 LPP (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve)

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Kompania e pastrimit Laguna sh.p.k. ka marre pjese ne tenderit e organizuar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit me numer te prokurimit: AQP/15/010/211 dhe me titull:Sherbime te pastrimit.

Pas njoftimit te anulimit kompania Laguna ka kerkuar qasje ne dokumentet e ofertuesve dhe i eshte mundesuar qasja ne dokumentet e ofertuesve me 09.03.2017. Ne qasjen e dokumenteve ne kemi verifikuar edhe nje here qe Laguna SH.P.K. e ka plotesuar dosjen e tenderit konforme kerkesave apo kritereve te njoftimit per kontrat dhe dosjes se tenderit dhe se pretendimet e AK nuk qendrojne. Kompania Laguna sh.p.k. nje here eshte shpallur fituese e ketij tenderi per Lot 1 dhe Lot 10 mirpo OE te tjere pas ankesave te tyre lenden e kane derguar ne OSHP. OSHP-ja ka nxjerr nje vendim 411/16,/413/16.416/16 dhe 417/17 me te cilin thuhet qe lenda kthehet ne rivlersim per LOT 1 dhe LOT 10 ku duhet te verifikohen referencat e OE te shpallur fitues.

AK nuk e ka verifiku siq duhet referencat ku ne letren standarde thuhet citoj : vlera totale e deshmive se ka perfunduar me sukses sherbime te pastrimit gjate tri viteve te fundit sipas dosjes se tenderit per tri Lote qe ju keni ofertuar eshte kerkuar 1 000 000 dhe vlera totale sipas deshmive te prezantuara eshte 797.03 e. Ky arsyetim i tyre apsolut nuk qendron ngase kompania Laguna sh.p.k. ka ofertuar me tri kontrata dhe referenca siq jane :

Kontrata e QKUK-se me reference ne vlere prej **2,521,969.47** euro ,kontrata e MPMS-se me referenc ne vlere prej **73,674.02** euro dhe kontrata e MKK-se me reference ne vlere prej **797.03** euro. Keto jane tri kontrata te lidhura me Institucione publike te Rep. se Kosoves dhe referencat i kane leshuar keto Autoritete (Institucone) te cilat jane te protokollune dhe te cilat e deshmojne shume qarte se kompania Laguna sh.p.k. ka perfunduar sherbime te pastrmit mbi vleren e kerkuar ne dosjen e tenderit pra mbi **1 000 000** euro ose saktesisht **2,596,440.52 euro.Vlene te potencohet se ne letren standarde thuhet se per 3 lote qe ju keni ofertuar eshte kerkuar 1.000.000 euro dhe vlera totale sipas deshmive te prezentuara eshte 797.03. Ni kete rast AK-**

AQP e ka marr per baze nje referenc e cila nuk eshte e perfunduar ndersa dy tjera nuk i ka marr per baze, si deshmi ju a prezentoj edhe referencat ashtu siq **kane gene ne dosjen e tenderit.** Edhe nje here e potencoj se AK ne dosjen e tenderit nuk ka kerkuar qe OF te kene kontrata te perfundune por jane kerkuar sherbime te realizuara.

Me kete rast kompania Laguna SH.P.K. e ka plotesuar kete kriter te dosjes se tenderit. Ne kemi pas qasje ne dokumentet zyrtare qe ka te beje me kete aktivitet te prokurimit dhe gjate qasjen ne dokumente kemi hasur ne nje kerkese per interpretim te cilin AK-AQP i ka kerkuar KRPP-se per interpretim.

Ne kete kerkese te cilen AK-AQP ja ka kerkuar KRPP-se e pranojn vet qe AQP- ja nuk i ka formuluar kriteret e qarta dhe si duhet dhe nuk ka kerkuar kontrata te perfunduara por sherbime.

Ndersa KRPP —ja i'a kthen nje pergjigjje se si eshte dashur te jene kriteret sipas LPP-se. Ndersa i'a cek nenin 56 pika 3 ne te cilin thuhet qe :

Tenderuesi, gjate procedurave te hapura, ose kandidati, gjate procedurave te kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do te diskualifikohet ose perjashtohet nga procedurat e tilla ne baza te ndonje kerkese ose kriteri qe nuk eshte i cekur ne njoftimin e kontrates dhe ne dosjen e tenderit.

KRPP shume qart e potencon se qdo here dominojne kriteret e dosjen se tenderit. Ne si OE nuk duhet te jemi viktim ne nje rast kur AKAQP nuk i ka formuluar kriteret siq duhet.

Ne zotohemi dhe jemi te bindur se kriteret te cilat jane kerkuar ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrat i kemi plotesuar nje qind per qind.

Nderkaq sa i perkete sigurimit te tenderit me te cilin pretendon AK se nuk e kemi vazhduar apsolut nuk qendron ngase kompania Laguna SH.P.K. sa here eshte kerkuar e ka vazhduar edhe validitetin edhe sigurimin .Si deshmi ju a prezentoj edhe nje here sigurimin e tenderit te vazhduar..

Prove:
Referencat me qarkullim,
Aneks 8 i plotsuar konform D.T. Sigurimet e tenderit,
Dy Interpretimet e KRPP-se Raporti i vlersimit te ofertave.

Dëmet Materiale

Konsiderojme se shkeljet e lartepermendura kane shkatuar humbje te konisiderushme materj ale dhe profesionale dhe kjo nga shkaku se kemi humbje materiale lidhur me kostot qe kane te bejne me pregatitjen e ofertave.
Kemi po ashtu humbje te konsiderushme edhe sa i perket pagesave per te siguruar garancionin bankar per sigurimin e tenderit.

Propozim

Kerkojme nga OSHP-ja qe te aprovohet ankesa jone dhe lenda te kthehet edhe nje here ne **Ri-vlersim** dhe qe AK-AQP te veproje konforme dosjes se tenderit dhe njoftimit per kontrate

N. 111,-*Operatori Ekonomik Ankues* "Uni - Project" me seli ne Prishtinë

***Pikat e Ankesës:* Lot 1 dhe Lot 10**

Është shkel neni 1 i LPP (Qëllimi)
Është shkel neni 6 i LPP (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)
Është shkel neni 7 i LPP (Barazia ne trajtim/Jo diskriminimi)
Është shkel neni 59 i LPP (Ekzaminimi , vlerësimi dhe krahasimi i tendereve)
Është shkel neni 65-72 i LPP
Është shkel neni 17 i Rregullave te Prokurimit Publik

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Duke marrë parasysh faktin se arsyetimet e dhëna për eleminim nga konkurenca të kompanisë tonë janë të njëjta si në rastin e vlerësimit të parë të ofrtave, atëhere edhe argumentet ligjore të potencuara në kërkesën për rishqyrtim do të janë të njëjta me argumentet ligjore të potencuara në kërkesënb për rishqyrtim drejtuar AQP-së me datën 09.11.2016 të tenderit për shërbimet e pastrimit ritenderim me nr.15 010 211

Shklejet a autoriteti kontraktues –AQP janë si në vijon:

1. Autoriteti kontraktues AQO me datën 08.03.2017 dërgon lertën standarte për tenderuesin e eleminuar dhe publikon njoftimin për anulim të kontratës. Në letrën standarte për tenderuesin e eleminuar jepen arsyet se kinse oferta e kompanise sonë është ofertë e pa përgjegjëshme (**Shih fakt nr.1 Letra standatrte për tendeuesin e eleminuar dhe njoftimi për dhënie të kontratës i publikuar në KRPP)**

2. Autoriteti Kontraktues — Agjencia e Prokurimit Publik, pas Vendimit te OSHP-se, fillon me procesin e ri-vleresimit te ofertave duke marre vendim per anulim te tenderit.
   Ne arsyetimet e dhena ne Raportin per Ri-v1eresimin e ofertave nga anetaret e komisionit per vleresimin e ofertave nuk jepen arsyetime figjore permbajtesore per eliminim nga konkurrenca te Kompanise 'TINT-PROJECT' per Lot 1 dhe Lot 10.

3. Ne kete drejtim, Kompania NPN UNI-PROJECT nuk pajtohet me vendimin e Komisionit per Ri-v1eresim te Ofertave kur ku ky Komision `persed ne menyre krejtesisht arbitrare ka zgjedhur qe te mos mane parasysh te gjitha deshmite e dorezuara nga kompania jone per kryerjen e sherbimeve te ngjashme gjate viteve 2013, 2014 dhe 2015.

   Anetaret e komisionit per vleresimin e ofertave kane shkelur ne kriteret e caktuara te v1eresimit te ofertave (cmimi me i ulte) duke mos perzgjedhur Kompanine tone fituese te tenderit ne Lotet e caktuara me arsyetim se nuk kemi plotesuar kerkesat e potencuara ne FTD te dosjes se tenderit dhe njekohesisht duke demtuar financiarisht edhe Kompanine `Uni Project' ne mos fitimin e kontrates publike.

   Duke u nisur nga v1eresimi subjektiv dhe jo-ligjor i zyrtareve te AQP-se, ne kundershtim me nenin 59 te LPP-se (procesi i vieresimit te ofertave), Kompania `Uni Project' eshte shpall e papergjegjsheme dhe jemi e1iminuar nga procedura e metejme.

   Eshte me rendesi te potencohet se Oferta e Kompanise 'LINT-PROJECT' ne tenderin e lartepermendur dhe ne Lotet e caktuara ka gene me e lire ne vlere prej 621 650.88 Em.o kundrejt O.E tjere pjesemarres.

   Pra, perkunder faktit se kompania jone i ka plotesuar te gjitha kerkesat ekonomiko financiare, jemi eliminuar padrejtesisht nga Autoriteti Kontraktues duke na u mohuar keshtu e drejta kushtetuese dhe ligjore per fitim te

kontratave ne rruge ligjore (shih fakt nr. 4— Procesverbali ha.pjes publike te ofertave);

4. Anetaret e komisionit per ri-vleresimin e ofertave ne konstatimet e tyre per oferten e Kompanise 'LINT-PROJECT' kane cekur se De1darata Tatimore per 3 vjetet e fundit nuk eshte vlere prej 4.300.000 euro por ne vlere prej 3.506.157 euro.

   Anetaret e komisionit per vleresimi e ofertave kane pasur mundesine ligjore qe te verifikojne ne ATK por edhe ne Kompani per dokumentet deshmuese per gjendjen ekonomike dhe financiare per tri vitet e fundit (2013, 2014 dhe 2105) per te konstatuar 1igjshem se kemi deshmi te mjaftueshme mbi vlren e kerkuar 4.300.000 €uro.
   Prandaj, Kompania `UNI-PROJECT' nuk e konsideron te ligjshme konstatimet e tyre ceshtjeti e kontestuar pa vere verifikim paraprak dhe ligjor ne Administraten Tatimore te Kosoves dhe

5. Anetaret e komisionit per ri-vleresimin e ofertave ne konstatimet e tyre per oferten e Kompanise `UNI-PROJECT' kane cekur se nuk kemi ofruar certifikatat perkatese ose ndonje dokument tjeter relevant qe deshmon performimin e tile te kontrates.
   Keto konstatime te anetareve te komisionit per ri-vleresimin e ofertave jane te pabazuara per arsye se ne Oferte kemi dorezuar mjaftueshem certifikata dhe referenca per kontratat e realizuara dhe te performuara gjate tri viteve te fundit qe e tejkalon shumen e kerkuar ne vlere prej 2.025.000 euro.
   Poashtu, poqese anetaret e komisionit per ri-vleresimin e ofertave kane pasur ndonje dyshim ose mungese te ndonje certifikate / reference per ndonje kontrate te realizuar kane mundur qe nepermjet nenit 72 te LPP-se te kerkojne scarime shtese dhe plotesim te dokumentacionit sa i perket certifikatave te kerkuara (shili fakt Ilf. 5 — ekstrakti i raportit te ri-vleresimit te ofertave.

Dëmet Materiale

Kompania `Uni-Project', .me plotesimin e te gjitha kerkesave/kushteve te tenderit ka interes te calctuar materialo-juridik ne parashtrimin e Ankeses dhe ka gene Ofertuesi potencial per fitimin e kontrates publike.

Vendimi i Agjencise Qendrore te Prokurimit por edhe te anetareve te komisionit per anulimin e tenderit 'pa ofrimin e argumenteve permbajtesore ligjore' ka demtu.ar rende interesat materiale financiare te Kompanise sone per mos fitimin e nje Kontrate publike ne menyre te rregullte dhe te drejte, e qe garantohet me Ligjin e Prokurimit dhe Kushtetuten e Kosoves.
Prandaj, mos fitimi i nje kontrate publike ne menyre te rregullte ndikon ne shpenzime te ndryshme ligjore, largimin e punetoreve nga puna, humbja e fitimit nga projekti i realizuar, si dhe reputacioni i Kompanise sone ne tregun e Kosoves.

Propozim

Duke u nisur nga prezentimi i argumenteve ligjore me arsyetim ligjor ne Ankese, Kompania `UniProject', kerkon nga Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues te Prokurimit te beje shoshitjen e fakteve ne menyre ligjore duke mane Vandim per te kthyer lenden e kontestuar ane RI-ITLERESINI tc Ofertave ne menyre qe te detyrohet Autoriteti Kontraktues — Agjencia Qendrore e Prokurimit, te beje Vleresim te drejte dhe objektiv te ofertave date procesit te serishem dhe te Ri te vleresimit te ofertave me anetar te rinj te komisionit per vleresimin e ofertave.

Kompania `Uni-Project' kerkon nga anetaret e panelit shqyrtues te OSHP-se te mos bazohet ne `arsyetimin' e pabazuar te AQP-se te mos i shqyrtoje argumentet tona te potencuara ne Ankese si `ceshtje' e shqyrtuar si nga AQP-ja dhe OSHP-ja gjate vitit 2016 me rastin e parashtrimit te Ankeses ngase AQP-ja me rasti ne ri-vleresimit te ofertave pas vendimit te OSHP-se nuk ka bere `verifilcim' te kapacitetit teknik dhe financiar sipas nenit 65 —72 te LPP-se ne asnje institucion public per te verfikuar deshmite e kerkuara teknike dhe financiare te prezentuara ne oferten e

Kompanise sone.

N. 111,-*Operatori Ekonomik Ankues* NPT Beni & Euroing ShPK me seli ne Suharekë

***Pikat e Ankesës:* Lot 1**

Është shkel neni 6 i LPP (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)
Është shkel neni 7 i LPP (Barazimi në trjajtim/Jo diskriminimi)
Është shkel neni 59 i LPP (Ekzaminimi vlereësimi dhe krahasimi itenderëve)
Është shkel neni 60 i LPP (Kriteri i dhënies së kontratës)
Është shkel neni 69 i LPP (Aftësitë teknike dhe/ose) profesionale

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Pasi kemi pranuar njoftimin per eleminim kemi analizuar mire formen B42 Leter Standarde per tenderuesin e eleminuar dhe kemi vrejtur se AK na ka eleminuar per:

1.Deshmite e kerkuara ne kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 e FDT dhe

2.Per mos vazhdimin e sigurimit te tenderit.

1. Ne kemi ofertuar per LOT 1,2,4,5,6,7,11

Kerkesa e pikes 9.1 te FDT per Lot /pjese qe ne kemi ofertuar eshte:

Kerkesa 1: Operatori ekonomik duhet te ofroje deshmi se ka perfunduar me sukses sherbime te pastrimit gjate tri viteve te fundit (duke filluar nga data e publikimit te ketij njoftirrui per kontrate) ne vlere prej, se bashku ne te tri vitet, prej jo me pak se:

1. Për Lot 1, 150.000,00 €
2. Për Lot 2, 50.000,00 €
3. Për Lot 4, 150.000,00 €
4. Për Lot 5, 200.000,00 €
5. Për Lot 6, 75.000,00 €
6. Për Lot 7, 150.000,00 €
7. Për Lot 11, 150.000,00 €

925.000,00 €

Deshmite e kerkuara ne Piken 9.2 e FDT jane:

Evidenca 1: **Operatori ekonomik duhet te plotesoj formularin standard te dhene ne Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit dhe te bashkengjis certifikatat perkatese ose ndonje dokument tjeter qe evidenton performimin e tille.**

Ne raportin e vleresimit thuhet se OE ka plotesuar nje liste sipas aneksit 8 ku OE ka ka prezentuar gjithsejt 15 kontrata te realizuara, mirepo prej 15 kontratave te prezentuara ne liste, komisioni ka vrejtur se deshmi ka ofruar vetem per 8 kontrata te prezentuara ! (pse permendet numri i kontratave dhe deshmive e nuk jane llogaritur vlerat e ketyre deshmive te ofruara siq jane kerkuar ne FTD pika 9.1).

Ketu komisioni ka bere shkelje te nenit 59 sepse nuk eshte perciendruar ne vleren e kerkuar qe eshte per 7 Lot/Pjese qe ne kemi ofertuar, sepse ne gjate pergaditjes se tenderit kemi shikuar shume qarte kete kerkese dhe JO rastesishte kemi ofertuar ne keto Lot/Pjese, dhe jemi bazuar ne deshmite/evidencen qe ne kemi. Po ua sqarojme se nga lista e 15 kontratave te prezentuara komisioni i vleresimit i ka pranuar vetem

deshmite e 8 kontratave si referenca e nuk ka marr parasysh deshmite tjera per kryerjen e sherbimeve te ketyre kontratave tjera.

Nga ato qe ka **cekur komisioni ne raportin e vleresimit, eshte dashur te llogariten edhe deshmite per kryerjen e sherbimeve edhe te Kontrates me Komunen e Prishtines, ku vlera mujore eshte 11,906.12** euro qe ne totalin e 13 muajve **deshmi kapin vleren prej: 154,778.00 euro pa llogaritur deshmite per sherbimet e kryera edhe ne 6 kontratat ne vazhdim.**

Dmth Referencat e pranuara nga komiosioni ne vlere prej **800,181.48** euro duhet shtuar edhe deshmite per kryerjen me suksese te sherbimeve te njeta ne vlere prej **154,778.00** euro nga kontrata me Komunen e Prishtin.es ku del totali prej: **954,959.48 euro. Me** kete plotesohet kerkesa mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale pika 9.2 e FDT / **Evidenca 1: Operatori ekonomik duhet te plotesoj formularin standard te dhene ne Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit dhe te bashkengjis certifikatat perkatese ose ndonje dokument tjeter qe evidenton peiformimin e tille,** qe per 7 LOT/Pjese te ofrtuara ka gene 925,000.00 euro.

Llogaria: **800,181.48** euro deshrni per sherbime te pranuara nga AQP-ja **154,778.00** euro deshmi nga Kontrata me K. e Prishtines te prezentuara ne dosje

Totali = 954,959.48 euro deshmi te prezentuara ne dosje per sherbime te pastrimit

954,959.48 euro > 925,000.00 euro kriteri i plotesuar nga OE

Vlene te theksohet se , ne per me i plotsuar kerkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare ne piken 8.1 FDT kemi marre ne konzurcium kompanin EUROING dhe kjo verteton qe ne e kemi kuptuar qe duhet te plotesohet edhe pika 9.1 e FDT, Kerkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale dhe per kete

arsye ne kemi prezentuar raportet deshmi dhe faturat ,mbi Icryerjen e sherbimeve te pastrimit qe ne menyre te plotesohet kjo kerkese nga AK.

Gjithashtu ju njoftojmë që AK e ka shpallë fituesin me kontratë të pa realizuar shiqone Aneksin **8 (thotë: Ky aneks është obligativ që të plotësohet dhe ti bashkangjiten çertifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton liferimin e tillë) Listën e kontratave të realizuara të OE fitues.**

Ju lutemi shih ne 9.2 Evidenca 1 ku thuhet OE duhet të plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 të dosjes së tenderit dhe ti bashkangjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton përformimin e tillë.

Ne kemi kërkuar nga KRPP interpretimin ligjor për pikën 9.2 për evidencën 1 dhe ne kemi marrë përgjigjëje pozitive, shih dëshmin nga KRPP të bashkangjitur kësaj lënde.

Për fund:

Ne deklarojmë se jemi të përgjegjshëm.

Dëmet Materiale

Ne si OE jemi demtuar gjate ketij procesi, ju e dini qe vetem vazhdimi disa her i sigurimit te tenderit, agazhimi i stafit per te marr vazhdimisht pjese ne kete proces te sterzgjatur te tenderit ka krijuar kosto te medha per ne si OE, dhe ne funde te diskriminohemi pa asnje baze te LPP-se, sepse pika qe ju keni cekur ne eleminim nuk është me bazë sepse ne e plotësojm këtë kriter, deshmite jane siq jane kerkuar në dosje, prandaj oferta është konform kritereve të dosjes.

Propozim

Kerkojme nga OSHP --ja qe lenda te kthehet ne **RIVLERSIM.**

Procesi i prokurimit

Data e njoftimit për kontratë(N.40) :	24.02.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16):	**Kontratë Kornizë** Sherbime/e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	25.05.2016 ora 14⁰⁰
Data e hapjes së ofertave (N.58) -	25.05.2016 ora 14³⁰
Data e njoftimit për anulimin e kontratës	08.03.2017

III.2 KUSHTET PËR PJESMARRJE

III.2.1- Kërkesat e përshtatshmërisë:

Kërkesa 1: Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237 . LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rks-gov.net.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Evidenca 1: Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2.

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit AQP ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të AQP-se për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor të përmendur, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet, do ti konfiskohet garancioni i sigurimit te ofertës dhe AQP do të vazhdojë me tenderuesin e radhës në rang-listë.

Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon:

a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. **(origjinali ose kopja e noterizuar)**

b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit *[para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]*. **(kopje)**

Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

Kërkesa 1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;

Kërkesa 2. Regjistrimi i Numrit Fiskal për kompanitë vendore

Dokumentet dëshmuese për përshtatshmëri profesionale

Evidenca 1. Certifikata e regjistrimit te biznesit – **kopje**
Evidenca 2. Certifikata e numrit fiskal - **kopje**

III.2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar
Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Agjencisë Qendrore te Prokurimit (AQP) se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit (2013-2014-2015) ka qenë në vlerë, se bashku ne te tri vitet, prej jo më pak se:

Për lot 1,	**300,000.00**	**Euro**
Për lot 2,	**100,000.00**	**Euro**
Për lot 3,	**500,000.00**	**Euro**
Për lot 4,	**250,000.00**	**Euro**
Për lot 5,	**400,000.00**	**Euro**
Për lot 6,	**150,000.00**	**Euro**
Për lot 7,	**300,000.00**	**Euro**
Për lot 8,	**1,000,000.00**	**Euro**
Për lot 9,	**3,000,000.00**	**Euro**
Për lot 10,	**700,000.00**	**Euro**
Për lot 11,	**300,000.00**	**Euro**

Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 apo me shume pjesë (lote), shuma totale e qarkullimit financiar qe kërkohet për Lotet për te cilat ai konkurron duhet të përmbushet nga OE.
Shembull: nëse qarkullimi i kërkuar për Lot 1 është 300,000.00 dhe për Lot 2 është 100,000.00 atëherë kërkesa minimale e qarkullimit e cila duhet te përmbushet nga OE është 400,000.00 euro

Dokumentet dëshmuese për gjendjen ekonomike dhe financiare
Evidenca 1: Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës për tri vitet e fundit (2013,2014,2015).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional
Kërkesat minimale mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale
Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses shërbime të pastrimit gjatë tri viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit te këtij njoftimi për kontrate) në vlerë prej, se bashku ne te tri vitet, prej jo më pak se:

Për lot 1,	**150,000.00**	**Euro**
Për lot 2,	**50,000.00**	**Euro**
Për lot 3,	**250,000.00**	**Euro**
Për lot 4,	**150,000.00**	**Euro**
Për lot 5,	**200,000.00**	**Euro**
Për lot 6,	**75,000.00**	**Euro**
Për lot 7,	**150,000.00**	**Euro**
Për lot 8,	**500,000.00**	**Euro**
Për lot 9,	**1,500,000.00**	**Euro**
Për lot 10,	**350,000.00**	**Euro**
Për lot 11,	**150,000.00**	**Euro**

Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 apo me shume pjesë (lote), shuma totale e kontratave për shërbime te pastrimit qe kërkohet për Lotet për te cilat ai konkurron duhet të përmbushet nga OE.
Shembull: nëse shuma totale e kontratave për shërbime te pastrimit e kërkuar për Lot 1 është 150,000.00 dhe për Lot 2 është 50,000.00 atëherë kërkesa minimale e kontratave te realizuara e cila duhet te përmbushet nga OE është 200,000.00 euro.
Kërkesa 2: OE duhet të posedoj numër te mjaftueshëm te pajisjeve për realizimin me sukses te kësaj kontrate, por jo me pak se:

Lot	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
Makine thithëse	5	10	5	5	5	5	5	2	10	10	20
Makinë për larjen e dyshemeve (pllakave të mermerit)	2	4	2	2	2	2	2	2	4	2	6
Karroca profesionale për pastrim	5	40	5	5	5	5	2	2	10	10	15
Makinë për kositjen e barit	/	2	2	1	1	1	1	/	3	1	2

Ne rast se operatori ekonomik dorezon tender për 2 apo me shume pjesë (lote)numri total i pajisjeve për Lotet për te cilat ai konkurron duhet të përmbushet nga OE.
Shembull: nëse numri minimal i makinave thithese te kërkuar për Lot 1 është 5 dhe për Lot 2 është 10, atëherë OE duhet te këtë 15 makina thithese.

Dokumentet dëshmuese për mundësitë teknike dhe/ose profesionale
Evidenca 1: Operatori ekonomik duhet te plotësoj formularin standard të dhënë në Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit dhe te bashkëngjis certifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër qe evidenton performimin e tillë.
Evidenca 2: OE duhet të dorëzoj një listë të pajisjeve për realizimin e kontratës

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publikeLOT 1, Lot 10 (N.58):Vetëm për OE ankues

Nr.	Emri i Tenderuesit	LOT	Çmimi €	Vërejtje
1.	"Laguna"	LOT 1.	17.678,39	jo
		LOT 10.	20.491,37	
3	"Uni-Projekt"	LOT 1.	14.750,03	jo
		LOT 10.	10.296,58	
5	"Beni & Euroing"	LOT 1.	16.983,085	jo

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se ne hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi dhe çmimi. Nuk ka pasur vërejtje për procesin e hapjes se ofertave nga asnjë operator ekonomik. Raporti i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes dhe përfaqësuesit e operatorëve ekonomik te pranishëm.

Kriteret për vlerësim

Kriteri për dhënien e kontratës (N.60):..... Tenderi i përgjegjshëm **Çmimi më i Ulët**

Komisioni vlerësimit pranë AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka formuar komisionin me vendimin e datës ***17.01.2017*** në përbërje prej tre anëtarëve:

1. Luan Kastrati, MPMS Kryetar
2. Luljeta Lokaj - AQP, Anëtar
3. Sundim Selmanaj – MAP, Anëtar

Data e mbarimit të vlerësimit të ofertave:.....03.03.2017
Data e e nënshkrimit nga zyrtari i prokurimit.....03.03.2017

Raporti i komisionit vlerësues

Komisioni vlersues konstaton se asnjëra nga kompanitë nuk janë të përgjegjëshme.

Deklarata e komisionit vlersues

Komisioni i rivlerësimit rekomandon zyrtarin e prokurimit anulimin e aktivitetit të prokurimit për Lot 1 dhe Lot 10 sepse nuk ka asnjë ofertë të përgjegjëshme. Komisioni i rivlerësimit ka verifikuar referencat dhe kontratat e operatorëve ekonomik **"Laguna"** sipas nenit 72 të LPP-së dhe Vendimit të OSHP-së për rivlerësim. Bazuar në vendimin e OSHP-së pjesa e fundit është konstatuar se OE konzorciumi " **Beni & Euroing**" janë të pa përgjegjshëm.

Komisioni i rivlerësimit ka kërkuar interpretim në KRPP me datën 07.02.2017 dhe ka pranuar përgjigjëjen me datën 27.02.2017 lidhur me kërkesën dhe evidencën.

Përfundim komisioni i rivlerësimit rekomandon autoritetin kontraktues AQP anulimin e Lot 1 dhe Lot 10 sepse nuk kemi asnjë ofertë të përgjegjëshme.

Rishqyrtimi i kërkesës nga Autoriteti Kontraktues

E datën 13.03.2017 autoriteti kontraktues ka pranuar kërkesat për rishqyrtim të parastruar nga OE **Kompania e Pastrimit "Laguna"** per **Lot 1 dhe Lot 10,** OE **"Uni-Projekt" Lot 1 dhe Lot 10** dhe **OE "Beni & Euroing"** per **Lot 1** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Sherbime te Pastrimit"** me nr. prokurimi AQP 15 010 211.
Me datë 14.03.2017 lidhur me kete kërkesë Autoriteti kontraktues mori këtë:

Vendim

Refuzohet ankesat e OE **Kompania e Pastrimit "Laguna" Lot 1 dhe Lot 10, OE "Uni-Projekt"** për **Lot 1** dhe **Lot 10 dhe OE "Beni & Euroing"** per **Lot 1** lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Sherbime te Pastrimit"** me nr. prokurimi AQP 15 010 211

dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës së Tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që ka pasur në dispozicion eksperti shqyrtues-teknik jep mendimin si në vijim:

Konstatimi: Nr. 1

Ky aktivitet i prokurimit është publikuar nga autoriteti kontraktues me procedurë të hapur. Lloji i kontratës është sherbime, kontratë publike kornizë me vlere te madhe. Ky aktivitet i prokurimit është i ndarë në 11 Lote. Në dosjen e tenderit janë dhënë informata përkatëse lidhur me kontratën në fjalë.

Dosja përfshinë të gjitha termet dhe kushtet materiale të sajë, procedurat e zbatueshme të prokurimit, kërkesa të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.
Kriteri i dhënies së kontratës është në harmoni me dispozitat e LPP-së.

Konstatimi nr. 2

Në vijim po japim një kronologji të shkurtër të këtij aktiviteti të prokurimit.
Ky aktiviteti i prokurimit ka filluar ne muajin shkurt të vitit 2016 me njoftimin për kontratë. Me datën 06.07.2016 komisioni vlerësues i autoritetit kontraktues ka përfunduar vlerësimin e ofertave. Gjatë vlerësimit të ofertave komisioni vlerësues për **Lot 1** dhe **Lot 10** ka shpallë të përgjegjshëm dhe ka rekomanduar për kontratë OE kompania e pastrimit **"Laguna" SH.P.K** , ndërsa për **Lot 7, lot 8** dhe **Lot 9,** komisioni vlerësues ka rekomaduar për kontratë OE **"Schaf Berger & Selmans networks Ahp & Hajdini Commerc.**
Me datën 13.07.2016, zyrtari kryesor administrativ (ZKA) i autoritetit kontraktues merr vendim për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe përmes një shkrese zyrtare që ja dërgon zyrtarit përgjegjës të prokurimit.
Zyrari përgjegjës i prokurimit bazuar në vendimin e ZKA-së të autoritetit kontraktues bënë njoftimin për anulimim në faqen e KRPP-së me datën 25.07.2016 për të gjitha Lotet.
Me datën 04.08.2016 dhe 05.08.2016 paraqesin ankesat në OSHP për Lot 1, Lot 7, Lot 8, Lot 9 dhe Lot 10 dy Operator Ekonomik.
Me datën 04.09.206 OSHP nxjerr vendimin me nr. 241-246/16 dhe aprovon ankesat e dy OE ankues në atë kohë për Lot 1, Lot 7, Lot 8, Lot 9 dhe Lot 10.
Pas marrjes së vendimit të OSHP, autoriteti kontraktues përsësi bënë anulimin e aktivitetit të prokurimit. Pas këtij anulimi, OSHP nxjerrë urdhëresën nr.241/16 dhe 246/16 me të cilën urdhëron autoritetin kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit konform vendimit të tyre.
Pas marrjes së urdhëresës nga OSHP, autoriteti kontraktues me datë 04.11.2016 bënë njoftimin për dhënien e kontratës për Lot 1, Lot 7, Lot 8, Lot 9 dhe Lot 10. Pas këtij njoftimi Operatorët Ekonomik ankues aktual paraqesin kërkesat për rishqyrtim në AK dhe më pastaj ankesat në OSHP.
Me datën 27.12.2016 OSHP-ja nxjerre vendim nr. 411/16, 413/16, 416/16 dhe 417/16 lidhur me keto ankesa obligon autoritetin kontraktues që për LOT 1 dhe Lot 10 ky aktivitet i prokurimit të shkoj në Ri-vlerësim.
Në përputhje me vendimin e OSHP-së, autoriteti kontraktues bënë Ri vlerësimin për Lot 1 dhe Lot 10. Si rezultat i Ri vlerësimit autoriteti kontraktues me datën 08.03.2017 bënë njoftimin për anulimin e këtij aktiviteti për Lot 1 dhe Lot 10.
Pas njoftimit për anulim tre OE ankues aktual paraqesin kërkesën për Ri shqyrtim në autoritetin kontraktues dhe pas marrjes refuzimit të kërkesave paraqesin ankesat në OSHP.
Ne tani do ta shqyrtojmë ankesat vetëm per **Lot 1 dhe Lot 10** per te cilat operatoret ekonomik kane paraqitur ankesë.

Konstatimi nr. 3

Gjatë shqyrtimit të kësaj lënde, Eksperti shqyrtues/teknik në përputhje me nenin 113 pika 1 të LPP-së, jep mendimin për pretendimet ankimore për të gjithë OE ankues si në vijim:

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues **"Laguna"** se gjatë rivlerësimit të ofertave autoriteti kontraktues ka marrë si valide vetëm një referencë në vlerë prej **797,03 euro** për një kontratë të pa përfunduar ndërsa për dy kontratat e tjera po ashtu të pa përfunduar nuk i ka marrë për bazë **qëndron**.

Është e çuditshme pse autoriteti kontraktues e pranon një referencë për një kontratë ende të pa përfunduar ndërsa dy referencat e tjera të kontratave po ashtu të pa përfunduara nuk i merrë për bazë.

Autoriteti kontraktues gjate vleresimit duhet të zbatoj kriter të njëjtë për situatat e njëta si në rastin konkret sepse në të dy rastet kontrata kanë qenë të pa përfunduara dhe referencat janë lëshuar vetëm për shërbimet e realizuara për një periudhuë të caktuar të kontratës po jo për gjithë kontratën e përfunduar.

Pretendimi i tjetër i OE ankues "**Laguna**" se autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit nuk ka kërkuar që tenderuesit të kenë kontrata të përfunduara por janë kërkuar shërbime të realizuar për mednimin e ekspertit përgjigjëja për këtë pretendim është në vendimin e OSHP-së me nr. 411/16, 413/16, 416/16 dhe 417/16 të datës 27.12.2016 ku ankesat e shumë operatorëve eknomik janë trajtuar si të pa baza dhe të pa përgjegjshëm pikërisht për shkak se kontratat nuk i kanë pasur të përfunduar deri në njoftimin e këtij aktiviteti të prokurimit.
Njëri prej tyre është edhe operatori ekonomik ankues i tanishëm kompania "Uni Projekt".

Nëse në vendimin e OSHP-së do të pranohej koncepti për "Shërbime të Realizuara" e jo kontrata të përfunduara, atëhere kompania "Uni Projekt" do të ishte e përgjegjëshme. Prandaj me vendimin e OSHP është vendosur që duhet të jenë kontrata të përfunduara. Për largimin e këtyre dilemave në **Aneksin 8 të dosjes së tenderit shumë qartë shkruan:**

"Lista e kontratave të realizuara në 3 vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë"
Ky aneks është obligativ që të plotësohet dhe ti bashkangjiten çertifikatat përkatëse ose ndonjë dokument tjetër që evidenton liferimin e tillë.
Prandaj si i tillë ky pretendim i OE ankues në fjalë **nuk qëndron**.

Pretendimi tjetër i OE ankues "Laguna" që lidhet me interpretimin e KRPP-së ku jepen përgjigjëje për interpretim në pyetjen e shtruar, mendimi i ekspertit është se ky interpretim nuk thotë që munden të pranohen referencat për kontratat e pa përfunduara ose të pranohen referencat e lëshuara për shërbime të realizuara për periudha të caktuara gjatë realizimit të kontratës.
Thjesht KRPP ka theksuar një dispozitë ligjore.

Pretendimi i fundit i OE ankues "Laguna" lidhur me vazhdimin e sigurimit dhe validitetit të tenderit, për mednimin e ekspertit teknik ky pretendim **qëndron**.
OE ankues në dosjen e tijë e ka sigurimin e vazhduar ne vazhdimësi sipas periudhava kur ka përfunduar.

Konstatimi nr. 4

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues **"Uni Projekt"** se është eleminuar në mënyrë të pa drejt dhe arbitrare nga komisioni i ri vlerësimit sepse nuk ka marrë parasysh dëshmitë e dorëzuara nga kompania jonë për kryerjen e shërbimeve të ngjashme gjatë tri viteve të fundit 2013, 2014 dhe 2015 për mendimin e ekspertit teknik **nuk qëndron**.
Dëshmitë për kryerjen e shërbimeve janë marrë për bazë, mirëpo ata nuk kanë qenë kontrata të përfunduara për ato shërbime të realizuara për tri vitet e fundit aq sa është kërkuar për lotet që keni konkuruar.
Përgjigjeje për këto pretendime të njëjta i keni marrë edhe në ankesën e më hershme nga eksperti por edhe në vendimin e OSHP-së me nr. 411/16, 413/16, 416/16 dhe 417/16 të datës 27.12.2016.
Tani kjo çështje u sqarua edhe më lartë që referencat duhet jepen për kontratat e relizuara lidhur me shërbimet e pastrimit sipas Aneksit 8 të dosjes së tenderit.

Konstatimi nr. 5

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues **"Beni & Euroing"** janë të njëjtat me ato të ankesës së më hershme për të cilat kemi dhënë mendim. Po ashtu lidhur me pretendimet e këtij operatori ekonomik sa i përket kontratës të pa përfunduar me komunën e Prishtinës është sqaruar edhe në vendimin e OSHP-së nr. 411/16, 413/16, 416/16 dhe 417/16 të datës 27.12.2016. Prandaj ky pretendim **nuk qëndron**.

Kontrata me komunën e Prishtinës ka qenë e pa përfunduar në datën e publikimit të njoftimit për kontratë për këtë aktivitet të prokurimit, prandaj edhe nuk është marrë për bazë nga autoriteti kontraktues.
Për shkak të ngritjes së çështjtjes nga OE **"Beni & Euroing"** të kontratave të pa përfunduar për OE "Laguna" në seancën dëgjimore të OSHP-së që është mbajtur herën e fundit për këtë aktivitet të prokurimit, OSHP me vendim ka kërkuar që për Lot 1 dhe Lot 10 ky aktiviteti i prokurimit të ri vlersohet dhe të sqarohen kontratat e OE "Laguna" a janë të përfunduara apo jo. Prandaj konstatimi se në dosjen e tenderit është kërkuar "Shërbime të Realizuara" e jo "Kontrata të Përfunduara" kuptohet me vendimin e fundit të OSHP-së për këtë aktivitet të prokurimit.
Ne për këtë çështje ne e dham mendimin edhe në kostatimin nr.3

Sa i përket pretendimit tjetër se AK e ka shpallë fitueisn me kontrata të pa realizuara. Për këtë pretendim ne nuk mundemi të japim mendim sepse nuk e dimë se për cilin aktivitet të prokurimit AK ka shpallë fituesin e kontratës me kontrata të pa realizuara por edhe nëse është ashtu, atëhere OE ankues është dashur të paraqes ankesë për këtë çështje brenda afatit të rregullt ligjor për parashtrim të ankesave e jo tani kur kanë kaluar të gjitha afatet ligjore.

Shkeljet e konstatuara të LPP-së

Gjatë vlerësimit të ofertave autoriteti kontraktues nuk ka respektuar në tërësi nenin 59 të LPP-së sepse gjarë ri vlerësimit të oferatave disa refernca për kontrata të pa përfunduara i ka marrë si valide ndërsa disa referenca tjera po ashtu për kontrata të pa përfunduara i ka marrë si jo valide. Kjo ka ndodhë te oferta e OE ankues "Laguna". Mirëpo ky devijim nuk e ndryshon vendimin e AK për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit për Lot 1 dhe Lot 10.

Përgjigje në pikat e ankesës

Përgjigjeje për pikat e ankesës janë dhënë në konstatimet e lartshënuara.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues/teknik

Bazuar në të gjithë dokumentacionin e shqyrtar për këtë aktivitet të prokurimit lidhur me pretendimet e OE ankues, çështja thelbësore e ankesave është se autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit ka kërkuar Referenca për Shërbime të Realizuara në 3 vitet e fundit e jo Referenca për Kontrata të Përfunduara në 3 vitet e fundit.

Eksperti teknik ndanë mendimin se referencat duhet të paraqiten për kontrata të realizuara sepse kjo kërkesë buron nga dispozita ligjore e nenit 69 pika 4.2 të LPP-së . Po ashtu për këtë çështje më forcon bindjen edhe më shumë përshkrimi te **Aneksi 8 i dosjes së tenderit** të këtij ktiviteti të prokurimit.

Nga kjo që u tha më lartë, Eksperti shqyrtues-teknik e vlerëson të **pjesërisht të bazuar** ankesën e OE ankues **"Laguna"** dhe të **pa bazuara** ankest e Operatorëve Ekonomik **"Uni-Projekt"** dhe **"Beni & Euroing".** Prandaj bazuar në gjitha konstatimet dhe sqarimet e dhëna gjatë shqyrtimit të kësaj lënde, eksperti shqyrtues/teknik në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon që autoriteti kontraktues – **Agjencia Qendrore e Prokurimit,** megjithëatë të mbajë në **fuçi vendimin për Anulim** te aktivitetit te prokurimit **"Shërbime te pastrimit" Lot 1 dhe Lot 10** sepse nuk ka bazë të arsyeshme për rivlerësim të ofertave.